

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 27.01.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Janar 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen, për kontributin që jepni në vendimarrjen në dobi të komunitetit të Lezhës. Sipas njoftimit që kemi marrë të gjithë, mbledhjen e sotme e kemi me këtë rend dite.

1. Projekt-Vendim “Për kriteret për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (Fondi 6%) për vitin 2025”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. T.B. dhe z. L.I. për djegie banese”
3. Projekt-Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit”, si dhe formatit të procesverbalit të konstatimit të kundravajtjes”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile, Bashkia Lezhë”
6. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks turistik, resort me suita 1,2,3,4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë nga shoqëria “Prince Adriatik Resort” shpk dhe shoqëria “Prince Junior” shpk”
7. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks banimi dhe shërbimi 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë nga shoqëria “Junik” shpk”
8. Projekt-Vendim “Për një ndryshim në VKB nr. 168, datë 10.07.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetëse, orareve dhe stacioneve të tyre, stacionet e linjave ndërqytetëse, terminalit të transportit të udhëtarëve, si dhe vendet e agjencive të transportit të udhëtarëve brenda vendit”
9. Projekt-Vendim “Për vendosjen e një statuje në nder të Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në lulishten përballë Memorialit”
10. Të ndryshme

-Erdhën këshilltarët Edlir Reçi dhe Ervin Coli.

-Ndue Luli: Krahas këtyre, sipas njoftimit që ju ka ardhë, kemi një projekt vendim shtesë, që ka të bëjë me heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë, z. Erin Pjetër Gjoni. Mbështetur në nenin 49 pika 4, germa B dhe neneve 54 e 55 të ligjit nr 139/2015 “Për

Vetëqeverisjen Vendore”, Kryesia e Këshillit të Bashkisë propozon heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhës z. Erin Pjetër Gjoni, për arsytet e dorëheqjes me anë të deklaratës notariale nr. 243 Rep. dhe nr. 148 Kol. datë 23.01.2025.

Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. Faleminderit.

Fillojmë me projektvendimin parë “Për kriteret për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (Fondi 6%) për vitin 2025”,

Në lidhje me këtë projekt vendim, kush ka ndonjë mendim? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 2, projekt vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. T.B. dhe z. L.I. për djegie banese”. Edhe në komisionin e emergjencave civile që u mbledh ditën e premte është diskutuar në lidhje me problemin, në qoftë se ka ndonjë problem edhe nga kryetari i komisionit, mund flaes. Nuk ka. Atëherë kush është dakord me këtë projekt vendim? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. Faleminderit.

Kalojmë te pika 3, projekt vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”. Fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: Në parim jam dakord. Tek pika 1, po ashtu jam dakord, por duhet të bëhet referimi tek kategoria, pra cilës kategori i përket dhe sipas pagës, që është vendosur këtu, duhet t'i përkasë kategorisë II-2, gjithashtu tek pika dy, rregullimin e pagës të pikës 25 dhe 26 të lidhjes 1, thotë sipas pagës të përcaktuar. nga projekti Fondit Social bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi, lidhja nr 1,2 dhe 3. Pra lidhjen nr. 1, 2 dhe 3, kemi në dispozicion. Lidhja 1 thotë, pika 25-26. Thoni konkretisht, ju lutem, te cili numër duhet ta dërgojmë këtë, që të bëhet rregullimi i saktë, duke iu referuar gjithë klasifikimit të pagave, pra pika e parë duhet rregulluar me atë, që të gjejë zbatim në bazë të ligjit dhe pika dy na thoni ku duhet saktësuar, faleminderit.

-Ndue Luli: Mendim tjetër? Nuk ka. Atëherë me këto ndryshime teknike, plotësime teknike që jep edhe kryetari i komisionit, kush është dakord për projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO, faleminderit.

Kalojmë te pika 4, projekt vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit”, si dhe formatit të procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes”. Në lidhje me projekt vendimin, kush e do fjalën? Po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Në fakt e kemi diskutuar edhe në komisionin përkatës, në parim, jam dakord, nuk kemi të bëjmë me një gjobë të re, por kemi të bëjmë me një kompetencë të re që i shtohet punonjësve të policisë bashkiake, e cila ka si qëllim, kuptohet, disiplinimin e trafikut në rrugët e qytetit e kryesisht siç e dimë afër shkollave, por përpara se sa të fokusohemi tek gjobat, unë mendoj që fokusi jonë si këshill bashkiak, por edhe i Bashkisë Lezhë, duhet të jetë tek dy probleme themelore ende të pazgjidhura. Së pari, kemi punonjësit e policisë bashkiake të cilët vijnë, pavarësisht vështirësisë në punë, të pagohen në kufinj të pagës minimale dhe referuar ndryshimeve të fundit të pagave të administratës së Bashkisë, punonjësit e policisë bashkiake pagohen deri katër, pesë dhe gjashtë herë më pak se sa të tjerë punonjës të administratës, çka i vendos ata në pozita të padrejta diskriminimi. Së dyti, unë i bëj thirrje Bashkisë Lezhë që të marrë masa urgjente për të zgjidhur problemin e parkimeve publike dhe kjo në mendimin tim, në opinionin tim zgjidhet duke zgjeruar qytetin e Lezhës, duke identifikuar hapësira të tjera përtej lagjeve tradicionale të Lezhës dhe gjej rastin t'i bëj thirrje përfaqësuesve të Bashkisë Lezhë që të heqin dorë nga projektet për kthimin e sipërfaqes së stadiumit të Lezhës dhe të lulishtes së lagjes 11 janari në sipërfaqe të betonizuar për parkime nëntokësore. Është një vendimmarrje e nxituar, zoti kryetar, është një vendimmarrje e pakonsultuar, që ka nxitur më pas edhe ndryshimet pandodhura më herët në planin e përgjithshëm vendor, një hark kohor më pak se sa 30 ditë, kështu që, në parim jam dakord për këtë marrëveshje, por unë i bëj thirrje Bashkisë Lezhë që ta vendosë fokusin tek trajtimi dinjitoz me paga i punonjësve të policisë bashkiake si dhe gjetjen e zgjidhjeve të arsyeshme dhe të drejta të vendeve të reja të parkimit për qytetin. Kam edhe një propozim tjetër, parashikohet në marrëveshjen e nënshkruar midis Bashkisë Lezhë dhe drejtorisë vendore të policisë, që 25% e këtyre gjobave do të kalojnë në buxhetin e bashkisë. Unë mendoj që është shumë pak, krahasuar me angazhimin e punonjësve të policisë bashkiake. Unë mendoj që kjo % duhet të jetë jo më pak se 50% e gjobave, detyrimisht të kalojë në buxhetin e Bashkisë Lezhë dhe më pas pse jo të adresohet për fuqizimin e kësaj strukture, faleminderit.

-Ndue Luli: Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, ky projektvendim s'ka lidhje me shkollat, si dolën shkollat s'e kuptoj, zonja këshilltare, domethënë duke etiketuar shkollat ti ke qejf me tregu veten si shpëtimtare të një gjëje të madhe, pastaj jo po s'të bëhet parkingu këtu, na tregon se ku bëhet parkingu, tani le të merremi me gjobat, pastaj më vonë e shohim atë punë. E para, kjo ka të bëjë me kalimin e gjobave në sistemin e gjobave të policisë së shtetit, që në fakt po e bën gjithë Shqipëria dhe që ne me kohë e kemi kërkuar, për arsye se policia e shtetit ka mekanizma më të shtrëngum për ta vjelë gjobën. dhe për ta marrë dhe kjo është një format domethënë standard marrëveshje me të gjithë bashkitë, e ka aktualisht Tirana që e ka bërë me kohë, tashti ne e kemi kërkuar dhe na është zgjeruar edhe te ne, përse i përket problemeve të tjera pastaj gjejmë një rast tjetër e flasim për gjobat, ky është kometi që kam unë, nuk është kompetencë e re kjo, po është një kompetencë që e ka policia bashkiake, por që në pjesën fundore në vjeljen e gjobave i shkon sistemit të gjobave të policisë së shtetit që ka dhe futen edhe gjobat e policisë bashkake brenda, kaq e thjeshtë është situata. Pra s'ka as kompetencë, s'ka as territor të nominuar, është gjithë territori i Bashkisë Lezhë kudo ku identifikohet një shkelje ku bashki, policia bashkiake del me gjobë.

-Ndue Luli: Mendim tjetër kush ka? Po zoti Marku.

-Agostin Marku: Në parim jam dakord, por tek pika një, mendoj unë, duhet bërë një rregullim. Të pashlyera kundërvajtjet rrugore të konstatuara nga policia bashkiake se këtu del sikur ne jemi duke marrë një vendim për të gjitha shkeljet dhe për të gjitha kundravajtjet, për kundravajtjet e veta, policia e shtetit e di vetë, ne po i japim një atribut nga ajo pjesa jonë dhe mirë bëhet, ndaj duhet cilësuar edhe mendoj se këtu tek vendimi nuk del qartë ajo që tha kryetari bashkisë, që futja në system edhe ndjekja e kësaj edhe në vazhdim. Është tek marrëveshja, por në vendim nuk është, pra të futen në sistem këto gjobat dhe të vjelen, ashtu siç veprohet edhe në Tiranë, që në të ardhmen mos të kemi raste të tilla që të na mbesin të prapambetura për arsye të mungesës së sistemit për gjobat që jepen nga policia bashkiake, pra të rregullohen këto dy gjëra në projekt vendim.

-Ndue Luli: Mendim tjetër? Nuk ka. Atëherë këtu dolën propozime. Në lidhje me propozimin parë për vjeljen e 25% të gjobave që t'i kalojnë bashkisë, por edhe me propozimin që dha zoti Marku këtu për ndryshime. Në lidhje me të parin, ç'mendim keni dhe kush është dakord me këtë, po zoti Torba e ka fjalën.

-Lirim Torba: Faleminderit kryetar. Në parim jam shumë dakord që vjelja e gjobave nga policia bashkiake t'i kalojë policisë së shtetit, por në qoftë se përmend marrëveshja dhe mundësia, që nga 25% ta rrisim pak sado pak që të vijnë këto të ardhura për Bashkinë Lezhë mirë do ishte, sikur edhe 35% besoj dhe policia e shtetit është në rregull se punën më të madhe e kanë policia bashkiake e Lezhës, të rritet baza nga 25 % në qoftë se e përmban ligji edhe mundësia e marrëveshjes me policinë, ta rrisim që të ardhurat e bashkisë të jenë pak më të larta.

-Pjerin Ndreu: Tani më fal, të bëj një sqarim që ta kemi më të qartë situatën, sot niveli i vjeljes së gjobave nga policia bashkiake në rastet e konstatuara është në nivele të papërfillshme, sepse njerëzit duhet me i kap në rrugë e pastaj kur t'i kapim në rrugë dalin këta heronjtë e politikës e thonë o shih si i keqtrajtojnë. Policia e shtetit e merr shërbimin komplet në dorë dhe ta kryen ajo, pra është një shërbim që do ta kryenim ne vjeljen e gjobave dhe e kryen policia e shtetit dhe kjo është një marrëveshje format që aplikohet te të gjithë dhe nuk është çështje dëshire, se me pasë dëshirën time unë i marr 100%, pra këtu nuk është se duam ne tashi të lëvizim shifrat apo të marrim protagonizmin edhe të themi - po unë e dua 50, unë e dua 100, ky nuk është diskutim për këtë sepse po ta marim sot, sot jemi në shifra të papërfillshme të vjeljes së gjobave. atëherë një strukturë që po ta marr përsipër unë gjobën thotë ama 25% do të lë ty 75% vetë, se ai e bën punën. Edhe ato që marrim në arkë në kuptimin ekonomik, të ardhma ekonomike, jemi shumë e shumë më mirë sesa jemi tashti. Kjo është situata dhe kjo nuk është pikë e diskutueshme, kjo është marrëveshje standard që kanë përdorë dhe ne po, i kemi shkuar për shtat, vjeljen e gjobës, që është pjesa më problematike në Shqipëri, do e bëjnë ata, ne s'do bëjmë asgjë.

-Ndue Luli: Qartë. Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje. Në fakt e kërkoja fjalën para se të bënte sqarimin kryetari, domethënë pasi e dëgjova me vëmendje dhe prandaj doja t'ju kërkoja që ta dëgjoni me vëmendje. Ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe këtë doja të thoja, jo çdo gjë ta marrim sikur ne

po themi tani, shiko ne duam këtë, duam atë, ta dëgjojmë mirë projekt vendimin, një projekt vendim që na vjen nga bashkia vetë, e cila është më e interesuar se të gjithë që të vjelë të ardhura, na tregon dhe na bën të qartë që ka ardhur një format. i cili është miratuar ligjërisht dhe është miratuar nga specialistë, jo thjesht nga dëshira dhe t'i kursejmë një çik këto diskutimet që nuk kanë vlerë, besoj, jo se nuk kanë vlerë për të rritur të ardhurat e bashkisë, por sensi dhe logjika e vendimit është e tillë, e miratuar në një format i cili është miratuar nga specialistë dhe tani të themi ne, mua më pëlqen që të marrim më shumë lekë këtu apo të marrim më shumë lekë atje, dakort, është mendimi jonë, mund ta shprehim, por të jemi një çik më konçizë dhe mos të hapemi me diskutime që mbase dhe nuk janë të nevojshme, faleminderit.

-Ndue Luli: Ka tjetër? Atëhere diçka, këtu kishim dy këshilltarë që diskutuan, njëri për ndryshim në përmbajtje të projekt vendimit, flas për propozimin e zonjës Marku, tjetri ishte për disa rregullime teknike, jo në përmbajtje por teknike të projekt vendimit, ai që ka të bëjë me ndryshime, kur flitet për ndryshimet në thelb të projektvendimit, patjetër që duhet të merret propozimi, por hidhet në votim, tani kush është dakord me atë, të ngrejë kartonin, unë për vete për shembull do ngre kartonin që mendoj unë. Pra e morëm vesh sqarimin edhe nga kryetari i bashkisë dhe nga të tjerët, flas që bëhet fjalë për ndryshim të përmbajtje të projektvendimit, projekt vendimi ka të bëjë vetëm me aktin e marrëveshjes midis nesh si bashki dhe policisë së shtetit, ku punën ia caktojmë ose ia lëmë ta kryejnë ata dhe ata i vjelin vetë,

-Ka reagime pa mikrofon nga këshilltarët.

-Pjerin Ndreu: Atëherë, në qoftë se do të ndryshojmë përmbajtjen, atëherë i bie që mos mos ta miratojmë projekt vendimin, pra policia e shtetit do ndalojë makinat në rrugë dhe do u thotë shoferave - ke tre gjoba në bashki, ke dy në polici të shtetit, do të shkosh t'i paguash tani, pra ata do e bëjnë punën komplet, po çfarë kuptimi ka kjo tashi sepse sot mundësia e vjeljes së gjobave nga ne është pothuajse zero. Policia e shtetit ta merr në dorë shërbimin komplet, zonja këshilltare, dhe këtu tashi protagonizmi me thënë që dëgjo se unë po çoj më shumë lekë në komunitet, është diskutim që nuk ia vlen për mua, kjo është një marrëveshje standard që nuk e kemi vetëm ne, e ka e gjithë Shqipëria, se edhe mua më intimidon ashtu duke thënë që pse mos ta bëjmë 50%, dakord, unë them që ta bëjmë 100%, mirëpo nuk është çështje dëshire kjo, kjo është çështje logjike dhe në një mënyrë e cila është tashmë e konfiguruar me bashkitë e tjera, ne nuk jemi të parë që e bëjmë këtë, ne jemi në nevojë këtu se gjithsesi të ardhurat që sjellim ne me ato që marrim sot i kemi më të sigurt këto që marrim,

-Donika Haxhia: Në qoftë se ne nuk kemi të drejtë të ndryshojmë marrëveshjen, atëherë pse duhet ta hedhim në votim propozimin?

-Pjerin Ndreu: Edhe njëherë sqarimi, në qoftë se do marrim përsipër me ndryshu termat, atëherë policia e shtetit do tërhiqet edhe ne do ngelemi as pa 25%, kjo është,

-Ndue Luli: Kush është dakord me projektvendimin me plus ndryshimet teknike që u diskutuan pak përpara? Miratohet me 25 vota Pro. Këshilltarët Emanuel Përbaku, Donika Haxhia, Donika Ndoj abstenuan (3 abstenime).

Vazhdojmë me pikën 5 projekt vendim “Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile, Bashkia Lezhë”. Për këtë, edhe komisioni përkatës ka diskutuar ditën e premte. Kush ka ndonjë mendim mund të flasë.

-Alfrida Marku: Komisioni nuk ka diskutuar dhe për këtë arsye unë kërkoj që përfaqësuesit e emergjencave të bashkisë të bëjnë një relativitet të plotë dhe shterrues.

-Ndue Luli: E qartë, atëherë drejtori i emergjencave ka fjalën.

-Paulin Gjergji: Përshëndetje të gjithëve, plani i emergjencave civile është një plan me afat tre vjeçar, domethënë 2024-2017.

-Ndue Luli: Më fal zoti drejtor, në qoftë se ke ndonjë diçka tepër relacionit mund të shtosh, relacionin e ka në duar secili këshilltar, kështu që mos i përsërit ato.

-Paulin Gjergji: Të gjitha janë të detajuara në relacion.

-Ndue Luli: Relacionin e kemi parë, ka ndonjë mendim tjetër, pyetje? Po.

-Alfrida Marku: Një pyetje se me aq sa kam lexuar është më shumë përshkrim i situatës sesa përcaktim i qartë i masave konkrete që do merren. Unë kam dy pyetje. Kur nis Bashkia Lezhë zbatimin e masave konkrete për vënien në praktikë të këtij plani që ju keni paraqitur, edhe gjatë gjithë vitit të kaluar në mbledhjet e këshillit ne kemi diskutuar për disa projekte në qytetin e Lezhës për ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, të cilat indirekt për pasojë do të ndikonin edhe në sistemimin dhe shmangien e situatave të përmbytjeve, ne nuk po i shohim këto ndërhyrje, kështu që këto janë zinxhir, kur nis zbatimi i këtyre parashikimeve që keni përfshirë në këtë plan të emergjencave si dhe kur nis ndërhyrja në sistemin e kanalizimeve në qytetin e Lezhës, faleminderit.

-Ndue Luli: Po, përgjigje?

-Pjerin Ndreu: Përgjigjem unë. E para, zbatimi i planit fillon mbasi ta miratojë këshilli dhe ta konfirmojë prefekti. E dyta, projekti është në zbatim sa për dijeni, se edhe sot më thanë "na ke rrejt te lagjja “Nënë Tereza”, se nuk ka filluar punë ujësjellësi, edhe m'i çuan me foto ku po hapen kanalet, në Gocaj-Kakarriq, aty ku ti do ta dish po përfundojnë, në Shëngjin, linja e Shëngjinit ka filluar punë dhe po bëhen azhurnimet e fundit, sepse ata janë gjermanë, nuk janë shqiptarë me fillu si të duam ne, po bëhen azhurnimet e fundit për të filluar në qytet, në qoftë se ndonjë nga këshilltarët ka qejf me i pa në terren, ne mund të shkojmë, nuk janë në fazën e fundit, por janë në fazën e fillimit, në Gocaj-Kakarriq janë në fazën, kanë avancu, edhe në qytet, thashë janë firmosë, është investim gjerman, kanë edhe ata kohën e vet, por janë në proces. Sigurisht që ka afat mbarimi, e ka dy vjet.

-Doli këshilltari Emirjon Mali.

-Erdhi këshilltari Argert Perkola.

-Ndue Luli: Atëherë, ka tjetër mendim? S'ka. Kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me votat Pro të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. faleminderit,

Kalojmë te pika 6, projekt vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks turistik, resort me suite 1,2,3,4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë nga shoqëria “Prince Adriatik Resort” shpk dhe shoqëria “Prince Junior” shpk”. Në lidhje me këtë projekt vendim është diskutuar, janë dy të tilla, njëri pas tjetrit, është diskutuar dhe në komisionin e këshillit, kush ka ndonjë mendim tjetër, po zoti Jaku.

-U kthye këshilltari Emirjon Mali.

-Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve, në lidhje me këtë projekt vendim për dhënien e dakordësisë së heqjes së një sasive prej 9.900 metra² nga fondi pyjor, ndër të tjera besoj se secili anëtar i këshillit është informuar nëpërmjet relacionit teknik, në bazë të ligjeve, ne kemi të drejtën për dhënien e dakordësisë, mbasi kjo sipërfaqe pyjore ndodhet në Malin e Rrencit, në zonën kadastrale 2568, për një sipërfaqe gjithsej të dyja parcelat së bashku përmbajnë rreth 9.900 metra², në bazë të kërkesës së shoqërive “Prince Adriatik Resort” shpk dhe “Prince Junior” shpk”, të cilat, kërkojnë për ndërtimin e një resorti turistik, pra në detaje jeni të informuar të gjithë për këtë. Komisioni i Bujqësisë e jep dakortësinë, por paralel me investimin të fillohet edhe rihabilitimi i sipërfaqes, konform ligjit që e lejon, pra si rregull kudo ku bëhen sipërfaqet pyjore tjetërsohen ose duhet të rehabilitohen dhe në bazë kësaj ne jemi të këtij mendimi si komision i bujqësisë, megjithatë anëtarët e këshillit do ta diskutojnë, ndërkohë është ligji që ne na jep të drejtën që paralel me investimin të bëhet edhe rihabilitimi i sipërfaqes që tjetërsohet, ju faleminderit, ju ftoj ta miratojmë.

-Ndue Luli: Po zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve, në fakt, nga ato çfarë na keni relatuar, fotoja del një goxha resort turistik investim i madh në Atlantikun verior, që ndoshta pak shqiptarë mund të kenë shansin që të shkojnë në atë zonë shumë të mirë, por normal që investimet nuk i bëjnë keq një vendi për t'u zhvilluar, por nga ana tjetër në fakt ne po sakrifikojmë tokë të fondit pyjor, muajin që ka kaluar një resort, muajin tjetër, muajin tjetër dhe për momentin është 1 hektar ose 10.000 m² që sakrifikohet, ndërkohë që nga ana tjetër drejtoria e bujqësisë flet për shtim të fondit pyjor, për biodiversitetin, mbrojtjen tokave nga erozioni, që është një problem shumë i madh zakonisht që vërehet në bregdet dhe për këtë marr shkas që të pyes se çfarë do të bëhet në lidhje me ruajtjen atij biodiversiteti të florës dhe faunës dhe sidomos të erozionit, sepse i takon që të dëmtohen shumë toka po themi resorte tani dhe më vonë sepse kjo ka mbetur malet që të bëhen resorte dhe të bëhen zona të urbanizuara duke sakrifikuar sipërfaqet e fondit pyjor, kështu që mendoj që kjo tokë nuk e di a është regjistruar si pronë publike apo pronë private dhe se është fondi pyjor dhe komuniteti aty komuniteti lokal çfarë përfitimesh do të ketë përveçse përfitime të disa biznesmenëve, po komuniteti lokal, a po mendohet për të, faleminderit.

-Ndue Luli: Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Unë bashkohem me shqetësimin e gjithkujt që mundohet me ngrit një shqetësim, përse i përket pyetjes, e para, ligjërisht është koeficienti në qoftë se pret një do të mbjellësh tre, është ligjore ajo, është e detyrueshme, në kuptimin e asaj nuk prish ndonjë gjë, e dyta, që t'jua bëj të qartë ju si opozitë, plani i përgjithshëm rregullues është miratuar këtu në këshillin bashkiak në mos gabofsha o 2018-ën, o 2017-ën nga këshilli bashkiak me propozim të kryetarit të bashkisë para meje, jo nuk kanë ndryshuar zonat fare, zonat e ndërtimit janë nga ato, aty ku bëhet resorti në fjalë, hajde t'i hapim bashkë edhe dalim ballë përballë njerëzve edhe nëse nuk është zonë ndërtimi atëherë unë kam faj. Kështu që këtë muhabet mos ma faturoni hiç direkt e indirekt mua, por është zonë e miratuar ndërtimi, e nderuar këshilltare, nga bashkia me planin rregullues që ka kaluar, kush do me e bë transparente unë e bëj, jam i detyruar unë se plani në moment që të miratohet ligji, më vjen shumë keq, në qoftë se s'e kupton këtë gjë, dhe e dyta, po nuk është çështje këshilli kjo tashi sot, më fal, të lutem edhe njëherë, edhe njëherë, të lutem, e treta ajo është tokë private, jo shtet, është e privatit, privati në përputhje me planin e përgjithshëm rregullues të miratuar nga këtu dhe të konfirmuar nga KKT-ja e kryeministri i shtetit, edhe që të jemi koshient, me konsensusin e partisë socialiste e demokratike në atë kohë, të dy bashkë, është përcaktuar zona ku bëhen ndërtime dhe unë një dhe ju dy, asnjë njeri nuk ka forcën as të drejtën që një privat në tokën e vet, në vendin ku është miratuar si zonë ndërtimi, të mos bëhet një projekt dhe ta miratojë, kjo pastaj çdo lloj debati është shashkë publike, sepse përputhet plani i përgjithshëm rregullues që është miratuar në këtë këshill me statusin e tokës që është tokë ndërtimi, me pronën private të personit dhe me të drejtën e tij të ligjshme, të kujtdo, për të aplikuar, kaq e thjeshtë është. Ndërsa pastaj se pritet një, ai ka detyrim ligjor për tre, ka detyrim ligjor, ai duhet duhet të thotë nesër ku e preu e ku mbolli tre.

-Ndue Luli: Zoti Tushaj e ka fjalën.

-Pjeter Tushaj: Përshëndetje, unë e kam lexu me shumë kujdes pjesën e kësaj dakordësisë për këtë edhe normalisht, çdo njeri që mund të ketë një tokë private që e ka ble, normal ai ble e ka se nga ku është ai s'ka mundësi me e pasë, edhe pretendon që të bëjë një ndërtim, resort apo hotel apo si janë këto të gjitha edhe unë mendoj që meqenëse kjo tokë është private dhe duhet të mbahen ato procedurat nga pyjet, edhe unë po të isha që të kisha toka, që s'kam pasë mundësi për ta ble, do të pretendoja për ta bërë një tip resorti, edhe aty mua si person nuk më shqetëson fare për arsye se një njeri që pretendon që të ndërtojë një resort edhe mund t'i favorizohet, kështu që unë mendoj që, po të ishte shtetërore, bëhet fjalë ndryshe, po të jetë tokë private ashtu, mundesh që të bëhet ky resort.

-Ndue Luli: Faleminderit, zonja Marku.

-Alfrida Marku: Unë do e shtroj pak ndryshe diskutimin. Ne si këshill, por edhe ju si kryetar i bashkisë, do të ishte mirë që përpara se të diskutojmë për ndërtime të reja në Shëngjin, nëse vërtet do ta donim Lezhën, nëse vërtet do ta donim Shëngjinin, nëse vërtet qëllimi ynë do të ishte tek zhvillimi i qëndrueshëm bashkëkohor i bregdetit të Shëngjinit si një zonë elitare, duhej pikë së pari të ishim të shqetësuar për ndërtimet pa leje në bregdetin e Shëngjinit në këto katër vitet e fundit, dhe për heshtjen e paarsyeshme nga ana e institucionit të Bashkisë Lezhë, nga ana e Inspektoriatit Vendor të Ndërtimeve, nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit,

kështu që ky duhet të ishte shqetësimi themelor për ne si përfaqësues të qytetarëve të Lezhës këtu në këshillin e Bashkisë dhe për ju si kryetar i bashkisë që detyrimisht keni përgjegjësi të monitoroni dhe të kontrolloni mbi çfarë ndodh në territorin e 10 njërive administrative të Bashkisë Lezhë. Për të vijuar sa i përket projekt vendimit në fjalë, kryetari i komisionit të bujqësisë e shprehu deri një farë pike, unë kam dy rezerva sa i përket këtij projekt vendimi, e theksoj unë gjithmonë kërkoj transparencë përpara se sat ë qartësohem për të marrë një vendim të caktuar në këshill, duhet në këtë projekt vendim detyrimisht, pra mungon një klauzolë e posaçme apo një marrëveshje midis Bashkisë Lezhë dhe subjektit që aplikon për këtë ndërtim, që këtë sipërfaqe toke me pyje që ai do ta asgjesojë për shkak se do të ndërtojë, ta rehabilitojë, ose ta kompensojë më saktë, në raportin 1 me 3 në një tjetër sipërfaqe publike të Bashkisë Lezhë. Kjo mungon qoftë në projekt vendim, qoftë nuk kemi një marrëveshje konkrete paraprake. Së dyti, në Komisionin e Bujqësisë kam kërkuar që ne si këshilltarë kemi të drejtë të informohemi mbi detaje të veçanta të kësaj iniciative, të këtij projekti, për çfarë projekti bëhet fjalë, sa është vlera e këtij projekti, por nga ana tjetër ne duhet të dimë se cili është kapaciteti financiar i këtyre subjekteve që aplikojnë për të zhvilluar dy projekte të tilla në Shëngjin, se nuk janë pak, janë 1,1 ha pyje që do të asgjesohen. Ne nuk kemi minimalisht bilancet financiare të tre viteve të fundit të këtyre subjekteve të cilat kanë aplikuar. Kështu që unë mendoj që mungesa e transparencës më detyron që ta rimendoj vendimmarrjen dhe të jem me të drejtë skeptike sa i përket këtij projektvendimi që ju keni paraqitur. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka mendim tjetër?

-Pjerin Ndreu: Edhe njëherë ta jap një përgjigje. E para e punës, Bashkia e Lezhës nuk bën marrëveshje në raste të tilla sepse të drejtën e lejes e ka KKT-ja. O zonjë kush ta ka mësuar se ti je pronare këtu dhe mund të bësh mund të shpikësh klauzola, është në ligj është e vendosur, nuk ke nevojë ti me mbrojt një gjë që është e përcaktuar saktësisht në ligj. E adreson Ministria e Turizmit këtë që çojmë ne, shkon në Ministrinë e Turizmit dhe kthehet në VKM, më vjen shumë keq po ti ke qejf me bë politikë dhe sidomos kur të vjen kamera aty përballë, po nuk është ashtu, mos shpik një artific që e ka ligji. Resortin e bën Ded Maluta, një ndër njerëzit më të mirë që ka biznesi në Lezhë. Nuk është detyrë e këshillit ajo, me bë analizë financiare të një subjekti, ku e ke dëgjua ti këtë? Po jo moj zonjë se ka mekanizma të tjera që e kontrollojnë këtë gjë. Ti mund t'ia dërgosh kërkesën çdo lloj institucioni, por nuk është detyrë e këshillit të bashkisë. Nuk më ngarkon ligji mua për të bërë verifikime financiare. Janë të tjera institucione që I ka nominuar shteti, që u ka dhënë të drejtën ligjore.

-Alfrida Marku: Po për ndërtimet pa leje, nuk the gjë.

-Pjerin Ndreu: Bashkia e Lezhës ka një drejtori urbanistike, mund të drejtohemi se sa leje janë dhënë dhe mbi ç'bazë ligjore. Sa për dijeni, nuk bën asnjë leje të ish komunës së Shëngjinit, dhe e dyta, ka një korespondencë Bashkia e Lezhës me institucione të tjera, ku hyn dhe prokuroria, për të parë, dhe ka disa çështje penale në prokurori që kanë fillu dhe mund t'u drejtohesh. Ka dhe ndërtime pa leje, ka dhe tentativa. Pyet në organet kompetente. Këtu nuk ka asgjë për t'u fshehur dhe bashkia është korrekte në vendimmarrjen e vet pikë e për pikë.

-Ndue Luli: Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 26 vota Pro. Këshilltaret Donika Haxhia, Donika Ndoj, Alfrida Marku abstenuan, 3 Abstenime.

Kalojmë te pika 7, projektvendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks banimi dhe shërbimi 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë nga shoqëria “Junik” shpk”, i cili vetëm se është projektvendim më vete, të njëjtën problematikë ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 26 vota Pro. Këshilltaret Donika Haxhia, Donika Ndoj, Alfrida Marku abstenuan, 3 Abstenime.

Kalojmë te pika 8, projektvendim “Për një ndryshim në VKB nr. 168, datë 10.07.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetëse, orareve dhe stacioneve të tyre, stacionet e linjave ndërqytetëse, terminalit të transportit të udhëtarëve, si dhe vendet e agjencive të transportit të udhëtarëve brenda vendit”

Në lidhje me p/vendimin, kush ka mendim? Po zoti Jaku.

-Dod Jaku: Në lidhje me këtë projektvendim, unë deshta të shpreh, përveç problemeve që kemi me transportin, në të gjitha drejtimet, me vendqëndrimet e mjeteve, oraret e mjeteve, vendet ku rrinë pasagjerët e një pafundësi problemesh, unë do t'i bëja thirrje dhe bashkisë që në qoftë se është e mundur nga ana financiare të bëhet diçka. Problem tjetër që këtu në këtë projekt vendim nuk është përfshirë një linjë dhe një zonë në njësinë tonë të Shënkollit, quhet zona e Myltes, bashkë me Sykajt, që është një zonë e populluar shumë dhe është nevojshme që edhe aty të përshkohet dhe të planifikohet një linjë urbane, ndoshta me orare më të reduktuara sesa linjat më kryesore, por ju lutem edhe kjo zonë të përfshihet, faleminderit.

-Doli këshilltari Pjeter Noka.

-Ndue Luli: Drejtorja e Shërbimeve ka fjalën për sqarime të shpejta.

-Specialisti: Përsëritet, shtesa që kemi bërë është se linja Shënkollit ka ngarkesë dhe ka kërkesë për një linjë të re, sikur kemi vepruar dhe në linjat e tjera të mëdha si Shëngjini, Kallmeti, ku kemi dy liçenca që veprojnë anasjelltas, kemi kështu dhe një linjë tjetër pikërisht për Shënkollin ku kishte mungesë, ngaqë edhe kompania që ka liçencën ka ngarkesë të madhe, nuk e menaxhon dot, tani shtojmë edhe një linjë tjetër aty.

Për pjesën që thotë zotëria do ta shikojmë, nuk ka pasë kërkesa nga privati të operojë në ato linja, duhet ta shohim edhe në vazhdim ta fusim në projekt vendim.

-Pjerin Ndreu: Mua më është thënë se është bërë një projekt paraprak që do të më paraqitet për një rikompozim të linjave, të cilësisë së automjeteve, të gjithë në kompleks që do vijë në këshill, nuk e di në çfarë faze janë, duhet ta thuash, e keni a s'e keni, nëse s'e keni, të mblidhemi dhe të vazhdojmë të ngrejme grupin dhe ta bëjmë, se në kuadrin e kësaj ne mund të adresojmë edhe disa linja të tjera të cilat ju mendonin se duhen shtuar, në këshill do vijmë dhe do ta shohim.

-Ndue Luli: Mirë, ka kush tjetër diçka? Atëherë kush është dakort me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, projekt vendim “Për vendosjen e një statuje në nder të Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në lulishten përballë Memorialit”. Zoti Marku.

-Agostin Marku: Jam dakord, është e vonuar, gjë mirë që bëhet tani, tek pika tre, edhe për vetë rëndësinë që ka ky projekt vendim, por edhe për arsyen që të zbatohet, të vihet në jetë, duhet të merren shumë institucione, ne nuk mund t’ia lëmë për zbatim Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës, por duhet ngarkuar kryetari i bashkisë, sepse janë shumë institucione që hyjnë në atë punë, por edhe nga ana ligjore, projekt vendimet duhet të ngarkohet kryetari i bashkisë në projekt vendimet për këshillin, kaq kam unë nga ana teknike, faleminderit.

-Ndue Luli: Zonja Haxhia.

-Donika Haxhia: Përshëndetje. Normalisht, siç e tha dhe parafolësi, është ajo që i mungon Lezhës, sepse e meriton të ketë një statujë, unë jam krejt dakord me këtë, edhe pozicionimi, vetëm për diçka, jam krejtësisht e paqartë, do të doja ta shikonim, sepse këtu thuhet që ka një maket për statujën e Skënderbeut, do të jetë bust apo statujë, dhe po edhe për ta parë, sepse së fundmi kemi parë lloj lloj gjërash, punimesh.

-U. kthye këshilltari Pjeter Noka.

-Pjerin Ndreu: Është pikë për pikë vendimi, vetëm vendi ndryshon, është vendimi i këshillit të përparshëm, i këshillit artistik, që ka marrë vendim, me të gjitha parametrat dhe pasi kemi konfirmuar që është njoftë e drejta e autorit, pra përputhet, është njoftë ligjërisht te institucionet përkatëse, ne kemi hy pastaj, se pa bërë atë procedurë ne nuk mund të hynim me statujë.

-Donika Haxhia: Ok se këtu nuk thuhej, faleminderit,

-Donika Ndoj: Një pyetje a mund të them? Cili mund të jetë afati i përfundimit të vendosjes së kësaj statuje, a mundet që deri në 2 mars të jetë e vendosur aty në përkujtim të Kuvendit të Lezhës?

-Pjerin Ndreu: Ne atë po mundohemi të bëjmë, do mundohemi ta bëjmë me 2 mars.

-Ndue Luli: Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Së pari e vlerësoj që më në fund mbas shtatë viteve të gjitha palët ranë dakord që po, edhe edhe në Lezhë duhet të ishte shtatorja e Gjergj Kastriotit. Unë kam besuar dhe gjithmonë besoj se koha është treguesi më mirë dhe se koha nxjerr në pah qëllimet e shprehura, por edhe të fshehura të gjithsecilit prej nesh, por nuk do fokusohem te çfarë na ndan, do fokusohem te çfarë duhet të na bashkojë, nisur edhe nga rëndësia historike dhe misioni i Gjergj Kastriotit. Unë uroj që kjo shtatore, sikurse dhe këshilltarja parafolese shprehu, kjo shtatore të vendoset në vendin e përcaktuar përpara datës 2 mars ashtu sikurse kërkoj që edhe miratimi në parlament i nismës ligjore për shpalljen e 2 marsit ditë feste zyrtare t’i paraprijë 2 marsit të këtij viti. Janë dy momente të cilat me të vërtetë do t’i jepnin Lezhës madhësinë që meriton në

historinë tonë kombëtare. Kam dy detaje, së pari theksoj që për mua prioritet ka vendosja e shtatores, por unë mendoj që shtatorja Gjergj Kastrioti duhet të jetë në sheshin e tij, në sheshin e Gjergj Kastriotit, duhet të jetë me fytyrë nga drita, duhet të jetë me shpinë nga vendvarrimi, por ritheksoj dhe njëherë, për mua rëndësi prioritare ka vendosja e kësaj shtatoreje. Së dyti, më lejoni që në emër të qindra qytetarëve të Lezhës, por edhe të shumë intelektualëve, t'ju kërkoj që ne si këshill bashkiak, por edhe ju si përfaqësues të Bashkisë Lezhë të ndërmarrim një nismë për rishikimin e kompleksit skulpturor të vendosur përpara bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe për heqjen e skulpturës e cila në një mënyrë komplet të paarsyeshme është vendosur në krah të At Gjergj Fishtës dhe më besoni opinioni publik do të na vlerësojë dhe do të na mbështesë. Unë nuk mund ta pranoj, më duket e paarsyeshme, më konsideroni dhe të painformuar, por e konsideroj të paarsyeshme në mënyrë absolute, që në krah të At Gjergj Fishtës të qëndrojë ajo skulpturë, apo pak metra larg shtatores së Gjergj Kastriotit të qëndrojë ajo skulpturë. I vlerësoj në mënyrë absolute të drejtën e autorit, e vlerësoj kapacitetin apo talentin e gjithsecilit, por Lezha nuk e mirëpret atë skulpturë, kështu që ne si këshill bashkiak dhe ju zoti kryetar i bashkisë, kemi për detyrë që të ndërmarrim nismën, të ndjekim hapat e duhur ligjor dhe procedural, që ajo skulpturë në krah të At Gjergj Fishtës dhe pak metra larg shtatores së Gjergj Kastriotit, që shpresoj do të vendoset pas pak ditësh, të zhvendoset. Kërkoj mirëkuptimin tuaj, bashkëpunimin tuaj dhe më besoni që opinioni publik e ka refuzuar që në fillim, e refuzon edhe sot edhe nëse ne ndërmarrim atë nismë, më besoni që do të na mbështesë, pa diskutitim, faleminderit.

-Ndue Luli: Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Më në fund ramë dakord. E para e punës njëherë, sot e asaj dite ajo është e papaguar. (Ndërhyn zonja Marku) Kjo zonja nuk pagoi në kohën e vet fare, kjo zonja nuk kishte të drejtën e autorit të konfirmuar për bustin që miratuan vetë, e treta nuk kishte lejen e Institutit të Monumenteve që duhet të shprehet sepse është zonë arkeologjike, e katërta nuk ishte e disponuar mbi bazën e këtyre dokumentave me leje nga bashkia vetë që do e vendoste. Ke pasur katër shkelje që ti nuk mundesh me e bë as unë se bëj dot me ato katër shkelje. Problemi është këtu, që mos të bëjmë politikë me këtë mos bëjmë politikë me këtë. S'ka qëllime ogurzeza dhe ogurbardha këtu. Është gjetë momenti, është gjetë financimi, është mbyllur dokumentacioni, bëhen të gjitha konform ligjit, jo konform qejfit të njërit dhe tjetrit, për me tregu se unë bëj këtë, ne nuk e kemi bërë se po ta bëhim ashtu do ta bëhim përpara, para se me marrë mandatin unë do ta bësha, nuk e bëra, kështu që kjo është situata, ne më në fund kemi konkluduar dhe ne nuk kemi bërë asnjë hap për me ardhë në këshill pa konfirmuar të drejtën e autorit. Unë kam qenë pro dhe sa për dijeni do të them edhe një tjetër gjë publikisht këtu, nëse më pyesnin mua, do e vendosnim aty, ku bëhej fjalë, s'na kanë leju as ne, nuk më kanë lejuar atëherë e kam gjetur një vend tjetër e kam propozuar një vend tjetër, tre vende kam propozuar, më miratuan njërin dhe presim që të jemi në harmoni edhe me Institutin e Monumenteve, kështu që kjo historia pastaj se ku kam qejf unë, ku ke qejf ti, është një problem tjetër që janë ca të tjerë ekspertë që e gjykojnë në mënyrë më të qartë, unë kam dëshirë me e vendos aty ku thu ti.

-Ndue Luli: Zoti Trashaj po.

-Alfons Trashaj: Përshëndetje të gjithëve, është një kënaqësi e madhe për Lezhën, vendosja e shtatores së Skënderbeut dhe besoj dhe në inaugurimin me 2 mars të kësaj shtatoreje nga Bashkia Lezhë. Unë kisha nja dy propozime për Bashkinë Lezhë, për vendosjen e shtatores, ngaqë unë e kam parë vendin ku do vendoset me drejtorin dhe me historianin, e kam studiuar dhe është shumë nevojshme zoti kryetar që dy kioskat që janë përballë asaj shtatoreje që do vendoset të lëvizin në një krah tjetër që të shihet më mirë ardhja e princave, njerëzve që vijnë me e vizitu këtë, është shumë mirë, i mirëmbënuar ai vend, sepse vende të tjera ku kishim dëshirë ishin punime arkeologjike në vazhdim dhe nuk u lejohet dhe e dyta heqja urgjente e atij lakuriqit përballë Fishtës që nuk di nga e personalizon Lezhën.

-Ndue Luli: Zoti Trashaj do të jap një përgjigje të shkurtër për këtë. Ne jemi këshilltarë, kemi të drejtë vendimmarrëse, kemi të drejtë propozimi kështu që 1/3 e këshilltarëve mund ta marrin këtë nismë, e paraqet në këshill, pra të ndjekim këto procedurat, një gjë që ne kemi mundësi me e bë. Tani kush është dakord me projektvendimin me një ndryshim të vogël fare teknik, ku në pikën tre të këtij projektvendimi thuhet, ngarkohet Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës, të bëhet, ngarkohet kryetari i bashkisë, sepse kështu duhet të jetë.

Kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 29 vota PRO. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: A mund të bëj një koment zoti kryetar?

-Ndue Luli: Po patjetër.

-Pjerin Ndreu: Unë tani po ju bëj transparente atë që mendoj unë, sepse sa herë mendoj unë thotë zonja këshilltare ke marrë vendim, unë s'kam marrë vendim, unë mendoj, për shembull edhe për stadiumin mendoj se duhet të ketë një parking edhe një park kreativ sipër ku të dalin gjithë moshat. Ti thua vendim, unë them s'kam marrë vendim, po të jetë për vendim, do të hap, më fal, më gjej planin e përgjithshëm rregullues, (I drejtohet drejtorit të urbanistikës) radhën tjetër në mbledhje të këshillit, publikisht kësaj zonjës, ku e kanë caktuar këta stadiumin, dakord, nëse stadiumi i bie të jetë caktuar aty ku është, ke të drejtë ti, më vjen shumë keq, e ke heq vetë, për lakuriqin jam dakord me e heq, po nuk kam pasë një dakordësi se është edhe një debat publik që mund të krijohet, për mua s'është problem fare, bëjmë një test si këshill ta heqim. Unë jam partizan i një skeme tjetër, që zona e Skënderbeut të jetë zona e Skënderbeut, një shesh, një shesh tjetër të jetë totalisht i dedikuar Fishtës me gjithë instalacionet dhe gjërat që mund t'ia dedikojmë Fishtës dhe s'kemi pse e lëmë Fishtën dhe Skënderbeun në një vend. Mund ta improvizojmë një shesh, biem dakord e themi sheshi "Gjergj Fishta" me të gjithë çfarë mund të dizajnojmë ne me autorë që i dinë këtë punë. Unë mendoj që sheshi Skënderbeg të jetë komplet në funksion të historisë që ka lidhje me Gjergj Kastriotin, brenda sheshin Skënderbeg nuk ka vend për një shesh tjetër, megjithatë, meqë është biblioteka s'na prish asnjë punë, e lëmë aty, po unë do isha më mirë me dizenu një shesh të dedikuar për Fishtën e një shesh të dedikuar për dikë sesa t'i bëjmë sheshet kështu njëri mbi tjetrin. Ai autori me disa historianë më shpjegojnë mua se ka një lidhje ajo se ç'lidhje ka unë nuk e shpjegoj dot me të thënë të drejtën se nuk ia them nga ajo punë merrni iniciativa, mua më keni pro me e heq.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Në lidhje me shtatoren ngjitur me shtatoren e At Gjergj Fishtës u shprehën dhe këshilltarët Erin Ndreca dhe Pjeter Noka.

-Ndue Luli: Atëherë kalojmë te projekt vendimi i fundit që ka të bëjë me heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë të zotit Erin Gjoni. kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota PRO. Faleminderit.

Kalojmë te pika “Të ndryshme”.

Fjalën e ka zonja Haxhia.

-Donika Haxhia: Unë do ngre një problem që shqetëson të gjithë, meqë unë banoj nga lagjja e pazarit. Aty nuk dalim dot nga shtëpia nga qentë. Duhet parë sepse kanë ardhë menjëherë, nuk ishin.

-Fatjon Zefi: Jam i informuar për situatën dhe edhe mbrëmë kanë qenë punonjësit e bashkisë në terren për t’u marrë me këtë punë.

-Ndue Luli: Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Floride Gunej
8

KRYETARI

